



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:250135

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05698981

P.nr.316/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurit E.B për shkak të veprave penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 401 par.5 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK) dhe veprës penale kanosja nga neni 181 par.3 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2077/22 të datës 22.11.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar më datë **06.03.2024**, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj dhe të pandehurit E.B se bashku me mbrojtësin e tij av. Valon Demiraj i caktuar sipas detyrës zyrtare, të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 03.04.2024, përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

E.B nga i ati Gj. dhe e ëma E. e gjinisë B., i lindur me datë ... në Istog, tani me vendbanim në fshatin G.rr. "Dëshmorët e Kombit" Komuna I., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, me gjendje të mesme ekonomike, me numër personal: ... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, *gjendet në vuajtje të dënimit në Qendrën Korrektuese në Dubravë për një veprë tjetër.*

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

- I. Me datë 26.09.2022 rreth orës 00:06 në fshatin Dobrushë Komuna Istog, me forcë, i pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare dhe atë zyrtarët policor Z.Sh. K.B

dhe A.F, në atë mënyrë që ditën kritike derisa zyrtarët policor kishin ndaluar të pandehurin i cili po qarkullonte me veturën e tij, e pasi që i njëjti nuk posedonte patentë -shofer, zyrtarët policor janë detyruar t'ia shqiptojnë gjobën për kundërvajtje dhe kërkojnë nga i njëjti që ta siguron një shofer që posedon patentë-shofer për ta larguar veturën në të kundërtën vetura do të hiqej me auto-bartës, me ç'rast i pandehuri nervozohet fillon të flas me zë të lartë dhe duke bërë me duar, shkon në drejtim të policëve duke ju drejtuar me fjalët “ *nuk mundem me siguruar shofer por liromani veturën*”, kur zyrtarët policor i japin urdhër verbal që ta ulë zërin dhe të mbajë distancën e sigurisë, i njëjti nuk i përfillë urdhrat dhe prapë tenton që t'i pengojë zyrtarët policor që t'ia shqiptojnë gjobën, duke u afruar tek vetura e policisë, e pasi policët i vendosin prangat të pandehurit për t'a arrestuar, i njëjti duke përdorë forcën kundërshton arrestimin.

- me çka ka kryer veprën penale **pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 401 par.5 të KPRK-së.**

II. Me datë 26.09.2022 rreth orës 00:06 në fshatin Dobrushë Komuna Istog, me qëllim të frikësimit seriozisht i kanos me fjalë zyrtarët policor dhe atë të dëmtuarit Z.Sh, dhe K.B, në atë mënyrë që gjersa i pandehuri i pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare si në dispozitivin e parë të këtij aktvendimi, më pas i njëjti ju drejtohet të dëmtuarve me fjalët “*nuk mundem me siguru shofer por liromani veturën, unë flas qysh të dua, nuk mundesh mem frikësu se vetëm e respektoj uniformën e policisë se ty nuk të shoh, nuk je kurrkush për mu dhe kemi me pas probleme unë dhe ti, unë nuk flas me ty por kam me ardh të shtëpia jote me bisedu me vëllezërit e tu pastaj, juve dyve kom me ju ardhur tek shtëpia dhe keni me pa se kush jam unë*”.

- me çka ka kryer veprën penale **kanosja nga neni 181 par.3 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenet e lartcekura të veprave penale dhe dispozitat e nenit 2, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 46, 47, 48, 49, 69, 76 të KPRK-së dhe nenet 242, 364, 369 të Kodit të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurit i:

CAKTON

- Për veprën penale në pikën I, pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 401 par.5 të KPRK-së, i caktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti.
- Për veprën penale në pikën II, kanosja nga neni 181 par.3 të KPRK-së, i caktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj.

Gjykata konform nenit 76, par. 1 dhe 2 të KPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM UNIK ME BURGIM

- I. Ashtu që, të pandehurit **E.B** i shqiptohet dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e tre (3) muaj, i cili *dënim do të jetë i kushtëzuar, nuk do të ekzekutohet*, nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej dy (2) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.
- **Në të kundërtën**, nëse i pandehuri brenda periudhës së lartcekur të verifikimit kryen vepër tjetër penale, atëherë gjykata në bazë të nenit 50 të KPRK-së, do t'a revokon dënimin me kusht dhe ndaj personit të dënuar do të ekzekutohet dënimi me burgim.
- II. **OBLIGOHET** i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej **njëzet (20) euro**, ndërsa në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej **njëzet (20) euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. **Palët e dëmtuara:** Z.Sh me vendbanim në rr. "Onix"nr.22, fshati B. Komuna I., K.B me vendbanim në rr. "Podguri" nr.24, fshati S. Komuna I. dhe A.F, me vendbanim në rr. "Tahir Haskaj" nr.12, fshati C. Komuna I., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1077/22 të datës 22.11.2022 kundër të pandehurit E.B për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 401 par.5 të KPRK-së si dhe veprës penale kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 06.03.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj dhe i pandehuri E.B se bashku me mbrojtësin e tij av. Valon Demiraj, i caktuar sipas detyrës zyrtare, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, dhe pas njoftimit me benifitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, i ka mundur të pandehurit të deklarojë për pranimin e fajësisë apo të deklarojë i pafajshëm.

I pandehuri E.B pas konsultimit me mbrojtësin e tij, ka deklaruar: se e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se është penduar për këto veprime, ju kërkon falje zyrtarëve policor të dëmtuar në këtë çështje

penale dhe i premtos gjykatës se ne të ardhmen do të këtë sjellje të mira dhe nuk do të kryej vepra penale.

Prokurori i Shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ka deklaruar: se pajtohet me pranimin e fajësisë, te deklaruar nga ana e të pandehurit për veprat penale për të cilat akuzohet, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe ka mbështetje ne provat qe gjendet në shkresa të lëndës, duke shtuar se me rastin e miratimit të pranimit të fajësisë, gjykatës i propozoj qe ndaj të njëjtit si rrethanë rënduese me rastin e marrjes së dënimit të merr parasysh faktin se në kryerjen e këtyre dy veprave janë të përfshirë me shumë se një i dëmtuar si dhe dënimet e mëparshme penale ndaj të pandehurit, ndërsa si rrethanë lehtësuese të marrë parasysh pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të pandehurit E.B av. Valon Demiraj, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ka deklaruar: se e mbështesë pranimin e fajësisë të bërë nga i mbrojturi im, ky pranim fajësie vie si rezultat i konsultimit me të njëjtin ashtu qe i njëjti është i njoftuar me pasojat dhe beneficionet e pranimit të fajësisë, meqenëse pranimi i fajësisë behet ne mënyrë të vullnetshme i propozoj gjykatës qe me rastin e marrjes se vendimit mbi dënim ndaj të pandehurit te zbatoj rrethanat lehtësuese në pajtim me ligjin.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata ne rastin konkret lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pas marrjes së mendimeve te lartcekura si dhe pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, par. 2 nën par. 2.1, 2.2 dhe 2.3, dhe par.3 të KPP-së, përkatësisht pas vlerësimit se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 242 par. 2, nën par. 2.4 të KPP-së, gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprat penale të lartcekura për të cilat është akuzuar.

Vendimi për shpalljen fajtor

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të pandehurin t'a shpall fajtor për veprat penale për të cilat është akuzuar dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, po ashtu në veprimet e tij manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprave penale të lartcekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe konstatimit nga gjykata të përmbushjes se kushteve në referim të nenit 242 par. 1, 2 dhe 3 të KPP-së, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Rrethanat që janë marre për bazë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si **rrethana**

lehtësuese ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe rrethanat personale se është penduar për veprat e kryera dhe kërkim faljen për palët e dëmtuara; ndërsa **rrethana rënduese** ka gjetur se i njëjti ka qenë i dënuar edhe më parë nga gjykatat me aktgjykime të formës së prerë në çështjet penale të evidentuara me numra të SMIL-it: 2021:124118, 2021:236703. Andaj, Gjykata në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në proporcion me peshën e veprave penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurit, i cili do ta kuptoj rëndësinë e veprës penale të cilën e ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektoj që në të ardhmen mos të shkaktoj veprime të ndaluara- përkatësisht mos të kryej vepër penale, si dhe do të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e tre (3) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej dy (2) viteve, nga dita kur ky aktgjykim merr formën e prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, me të cilin dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit me kusht sipas nenit 47 të KPRK-së, përkatësisht që të mos zbatohet dënimi për vepra penale kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e mjaftueshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Gjykata, të pandehurit me anë të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim, i'a tërheq vërejtjen seriozisht dhe i bëhet me dije se nëse kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës kohore të verifikimit, dënimi i cili ka qenë i kushtëzuar për një kohë të caktuar, do të ekzekutohet.

Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 452 par. 1 dhe nenit 449 par. 2 të KPP-së, e ngarkoi të akuzuarin me shpenzimet e procedurës të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e po ashtu konform nenit 39 par. 3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, e obligoi të paguaj taksën për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

Udhëzimi i palës së dëmtuar për kërkesat pasurore-juridike

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, është marr konform nenit 462 par.2 të KPP-së.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 242, 364 dhe 369 të KPP-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

Procesmbajtësja
Hale Ahmetaj

GJYQTARI
Petrit Nrecaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovë në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*